

HULUMTIM **MBI**

VIKTMIZIMIN NGA KRIMI I URREJTJES

RAPORT

**HULUMTIM MBI VIKTMIZIMIN NGA
KRIMI I URREJTJES
RAPORT**

Poll Iganski

janar 2019

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

343.3/.7-058.6:316.647.5(497.7)(047.31)

ИГАНСКИ, Пол

Истражување за виктимизацијата поради криминал од омраза [Електронски извор] : извештај / Пол Игански. - Скопје : ОБСЕ, 2018

Начин на пристап (URL): <https://www.osce.org>. - Текст во PDF формат, содржи 48 стр., илустр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 21.12.2018. - Текст на мак. алб. и англ. јазик. - Содржи и:

Hulumtim mbi viktimizimin nga krimi l urrejtjes : raport ; Hate crimes victimization survey : report

ISBN 978-608-4788-41-6

а) Криминал од омраза - Жртви - Македонија - Истражувања COBISS.MK-ID 109196298



Përmbajtja e këtij publikimi nuk reflekton çdoherë këndvështrimet dhe qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

QËLLIME DHE OBJEKTIVA

- ◆ Ky raport ofron gjetje kyçe nga një hulumtim mbi viktimizimin nga krimi i urrejtjes që u zhvillua në Maqedoninë e Veriut në qershor dhe korrik të vitit 2018.
- ◆ Hulumtimi kishte për qëllim të ofrojë një pasqyrë më të plotë të viktimizimit nga krimi i urrejtjes dhe efektet e tij, në krahasim me atë që më parë ka qenë e qasshme nga numri i vogël i krimeve të urrejtjes të raportuara më parë nga të dhënat administrative dhe të dhënat e OJQ-ve në Maqedoninë e Veriut.
- ◆ Qëllimi ishte të ofrohej dëshmi për nevojën e zhvillimit të masave efektive që do të jenë të përshtatshme dhe që do të luftojnë kundër krimit të urrejtjes, që do të udhëzojnë politikën dhe strategjinë e synuar nga autoritetet kombëtare dhe lokale dhe do mbështesin organizatat e shoqërisë civile në punën e tyre përfaqësuese.

DIZAJNI I HULUMTIMIT

- ◆ Hulumtimi është dizajnuar që të maksimizojë potencialin e përjetimit të përvojës së viktimave të krimit të urrejtjes duke u përqendruar në komunat me laramani më të madhe etnike me mendimin se krimet e urrejtjes kanë më shumë gjasa të ndodhin në zona të tilla krahasuar me zonat me laramani etnike më të vogël.
- ◆ Në sondazh u përfshin 1510 të anketuar të moshës 15 vjeçare dhe më të rritur.
- ◆ Intervistat u zhvilluan me ndihmën e tabletit (Tablet assisted self-interviews - TASI) ku të anketuarit plotësuan një pyetësor me përdorimin e tabletit që e kishte intervistuesi dhe me ndihmën e intervistuesit nëse kërkohej e njëjta.

PËRVOJA ME KRIMIN NË PËRGJITHËSI

- ◆ Duke përdorur numrin minimal të nevojshëm për rezultate të besueshme, vetëm një nga 6 të anketuar (17,5%) ka pasur përvojë me krim në 12 muajt para hulumtimit të zhvilluar.
- ◆ Është për t'u theksuar se shumë pak të anketuar kanë raportuar se janë sulmuar fizikisht, që kanë përfunduar me ose pa dëmtime.

PËRVOJA ME KRIMIN E URREJTJES

- ◆ Thuajse, 1 nga 10 të anketuar (9.1%) kanë thënë se kanë pasur përvojë me krim në 12 muajt para hulumtimit të zhvilluar.
- ◆ Duke përdorur numrin aktual të personave të prekur, 165 të anketuar në anketë kanë raportuar se kanë qenë viktime të së paku një krimi të urrejtjes gjatë vitit të kaluar.
- ◆ Shkalla e viktimizimit nga krimi i urrejtjes për komunat e Kërçovës dhe Gazi Babës ishin shumë më të larta se shkalla e viktimizimit nga krimi i urrejtjes nga tërë mostra e të anketuarve në hulumtim. Shkalla për komunat e Tetovës dhe Strugës ishte pothuaj se sa gjysma e shkallës së viktimizimit nga krimi i urrejtjes për tërë mostrën e të anketuarve në hulumtim.

KRIMI DHE VIKTIMIZIM NGA KRIMI I URREJTJES SIPAS KARAKTERISTIKAVE TË VIKTIMAVE

- ◆ Një përqindje të ngjashme të femrave dhe të meshkujve kanë raportuar se kanë qenë viktimë e krimit të urrejtjes në 12 muajt para hulumtimit (femra 8,9%, meshkuj 9.3%)
- ◆ Të anketuarit më të rinj kishin më shumë gjasa që të raportonin se kishin qenë viktimë e krimeve të urrejtjes në 12 muajt para hulumtimit sesa të anketuarit më të moshuar. Por viktimat haseshin në tërë spektrin e të anketuarve në hulumtim.
- ◆ Të anketuarit romë raportuan shkallën më të lartë të viktimizimit nga krimi i urrejtjes brenda 12 muajve para hulumtimit krahasuar me grupet e tjera etnike.
- ◆ Kur u pyetën për orientimin seksual, shumica e të anketuarve thanë se ishin heteroseksualë (88.7%). Një numër i konsiderueshëm i të anketuarve thanë se “preferojnë të mos thonë” (132 nga 1510 të anketuar). Duhet theksuar se secili nga tetë të anketuarit që kanë thënë se janë “homoseksual” për nga orientimi seksual, ka qenë viktimë e krimit të urrejtjes në 12 muajt para hulumtimit.
- ◆ Në mes të të anketuarve të cilët kanë thënë se kishin një problem shëndetësor fizik ose mendor ose sëmundje që zgjat ose pritet të zgjas për 12 muaj, 11.4% (26 të anketuar) raportuan se kishin përjetuar krime të urrejtjes në 12 muajt para hulumtimit.

AUTORËT E KRIMIT TË URREJTJES

- ◆ Të panjohurit ishin tipi i autorëve më të zakonshëm të krimit të urrejtjes. Megjithatë, një përqindje më e lartë e viktimave të krimeve të urrejtjes deklaroi se kryerësi ishte një fqinj, ose dikush tjetër nga lagja, apo dikush tjetër që ata e njihnin.
- ◆ Më pak se një në njëzet viktimat të krimeve të urrejtjes thanë se autorët ishin adoleshentë dhe një përqindje e ngjashme thanë se autorët ishin huliganë të futbollit. Vetëm një viktimë e krimeve të urrejtjes tha se autori i krimit kishte qenë anëtar i një grupi ekstremist.

VEPRIMI I POLICISË PAS KRYERJES SË KRIMIT TË URREJTJES

- ◆ Gjashtë nga dhjetë (60.1%) të anketuar për të cilët krimi më serioz që kanë përjetuar në 12 muajt e fundit ka qenë një krim nga urrejtja deklaruan që krimin nuk e kanë denoncuar në polici.
- ◆ Arsyeja më e shpeshtë e ofruar nga pak më shumë se një e treta e viktimave të krimeve të urrejtjes për mos denoncimin e krimit më të rëndë që kishin përjetuar ishte pohimi se kjo është diçka që ndodh. Një nga gjashtë viktimat e krimeve të urrejtjes thanë se ka qenë pa rëndësi dhe nuk ia vlente të denoncohet.
- ◆ Një e treta e viktimave të krimeve të urrejtjes gjithashtu thanë se nuk ishin të sigurt se policia do të ishte në gjendje të bënte gjë, dhe një numër i vogël - pak më shumë se një në njëzet viktimat të krimeve të urrejtjes – kanë deklaruar se policia nuk do të ishte shqetësuar apo interesuar.
- ◆ Viktimat e krimit të urrejtjes kishin më pak gjasa të thonë se ishin trajtuar në mënyrë të drejtë dhe me respekt nga policia.
- ◆ Sidoqoftë, viktimat e krimeve të urrejtjes kishin më tepër gjasa të thonë se policia i mbante të informuar për përparimin në rastin e tyre sesa viktimat e krimeve të tjera dhe se kanë përjetuar një nivel pak më të lartë të kënaqësisë lidhur me mënyrën se si policia ka trajtuar çështjen e denoncuar.

EFEKTI I VIKTIMIZIMIT NGA KRIMI I URREJTJES

- ◆ Për secilën prej masave të ndikimit post-viktimizues të përdorur në këtë hulumtim, viktimat e krimeve të urrejtjes si grup kanë pasur me shumë tendencë të raportojnë nivele më të larta të ndikimit sesa viktimat e krimeve të tjera.
- ◆ Viktimat e krimit të urrejtjes si grup kanë pasur gjasa më të madhe sesa viktimat e krimeve të tjera të tregojnë se si rezultat i krimit të urrejtjes kanë pasur probleme me familjarët dhe miqtë.
- ◆ Viktimat e krimeve të urrejtjes si grup kanë pasur më shumë gjasa të raportojnë ndikimin psikologjik të post-viktimizimit, sesa viktimat e krimeve të tjera.
- ◆ Edhe viktimat e krimeve të urrejtjes kishin më shumë gjasa të raportonin simptoma psikosomatike
- ◆ Për secilën prej masave të përdorura në anketë lidhur me shqetësimet për viktimizimin e mundshëm nga krimi ndër-personal, viktimat e krimeve të urrejtjes në hulumtim kishin më shumë gjasa sesa viktimat e krimeve të tjera për të deklaruar se ishin shumë të shqetësuar dhe mjaft të shqetësuar.

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	8
Qëllimet dhe objektivat e hulumtimit	8
Struktura e raportit	9
2. DIZAJNI I HULUMTIMIT	10
Dizajni i mostrës.	10
Përzgjedhja e mostrës.	10
Madhësia e mostrës.	11
Puna në terren.	11
Paraqitja e rezultateve të hulumtimit në këtë raport.	11
Interpretimi i rezultateve të hulumtimit në këtë raport	12
3. PËRVOJA ME KRIMIN NË PËRGJITHËSI	13
Numërimi i viktimizimit nga krimi i urrejtjes	13
Llojet e krimeve të përjetuara	13
4. PËRVOJA ME KRIMIN E URREJTJES	16
Llojet e krimeve të urrejtjes të përjetuara.	17
Viktimizimi nga krimi sipas komunave	18
Viktimizimi nga krimi i urrejtjes sipas komunave	19
5. KRIMI DHE VIKTIMIZIMI NGA KRIMI I URREJTJES SIPAS KARAKTERISTIKAVE TË VIKTIMAVE	20
Gjinia dhe viktimizimi nga krimi	20
Gjinia dhe viktimizimi nga krimi i urrejtjes	20
Mosha dhe viktimizimi nga krimi.	20
Mosha dhe viktimizimi nga krimi i urrejtjes	21
Përkatësia etnike dhe viktimizimi nga krimi	22
Përkatësia etnike dhe viktimizimi i nga krimi i urrejtjes	22
Feja dhe viktimizimi nga krimi	23
Feja dhe viktimizimi nga krimi i urrejtjes	23
Orientimi seksual dhe viktimizimi nga krimi.	23
Orientimi seksual dhe viktimizimi nga krimi i urrejtjes.	24
Paaftësia dhe viktimizimi nga krimi	25
Paaftësia e viktimizimit nga krimi i urrejtjes.	25
6. AUTORËT E KRIMEVE TË URREJTJES	26
7. VEPRIMI I POLICISË PAS KRYERJES SË KRIMIT TË URREJTJES	27
Denoncimi i krimit të urrejtjes në polici	27
Trajtimi nga policia	28

8. NDIKIMI I VIKTIMIZIMIT NGA KRIMI I URREJTJES	30
Të qenit të prekur nga viktimizimi nga krimi	30
Efektet socio-ekonomike	31
Efekte psikologjik	31
Shqetësimi rreth viktimizimit potencial nga krimi	32
Simptoma psikosomatik	34
Sjellja e shmangies së krimit	35
Reaksione post-traumatike të stresit	36

9. KONKLUZIONE	38
---------------------------------	----

Lista e figurave dhe tabelave

FIGURA

Figura 1: Llojet e krimeve të përjetuara gjatë vitit të kaluar	14
Figura 2: Numri i veprave kriminele të përjetuara në vitin e fundit sipas llojit të krimit	15
Figura 3: Numri i të anketuarve që kanë përjetuar krim të urrejtjes gjatë vitit të kaluar sipas llojit të krimit	17
Figura 4: Viktimizimi nga krimi sipas komunës	18
Figura 5: Viktimizimi nga krimi sipas komunës	19
Figura 6: Moshë dhe përvoja me viktimizimin nga krimi	21
Figura 7: Moshë dhe përvoja me viktimizimin nga krimi i urrejtjes.	21
Figura 8: Përkatësia etnike dhe përvoja me viktimizimin nga krimi	22
Figura 9: Përkatësia etnike dhe përvoja me viktimizimin nga krimi i urrejtjes.	23
Figura 10: Orientimi seksual dhe përvoja me viktimizimin nga krimi.	24
Figura 11: Orientimi seksual dhe përvoja me viktimizimin nga krimi i urrejtjes	25

TABELA

Tabela 1: Autorët e krimeve më të rënda të përjetuara nga të anketuarit	26
Tabela 2: Arsyet për mos denoncimin e krimit në polici	27
Tabela 3: Trajtimi i policisë	29
Tabela 4: Të qenit të prekur nga viktimizimi nga krimi	30
Tabela 5: Problemet socio-ekonomike pas viktimizimit nga krimi	31
Figura 12: Efekti psikologjik mbi viktimat e krimit të urrejtjes	32
Tabela 6: Shqetësimi rreth viktimizimit potencial nga krimi	33
Figura 13 : Reaksion psikosomatik pas viktimizimit nga krimi	35
Tabela 7: Sjellja e shmangies së krimit	35
Tabela 8: Reaksione post-traumatike të stresit	36

SHTOJCAT

Shtojca 1	39
Shtojca 2	40

1. HYRJE

Ky raport paraqet rezultatet e hulumtimit mbi viktimizimin nga krimi i urrejtjes që u zhvillua në Maqedoninë e Veriut në qershor dhe korrik 2018. Hulumtimi ishte unik. Është hulumtim i parë me mostër të të anketuarve që ka për qëllim të analizojë përvojën me krimin e urrejtjes në Maqedoninë e Veriut.

QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E HULUMTIMIT

Të dhënat administrative mbi krimin e urrejtjes në Maqedoninë e Veriut tregojnë vetëm një numër të vogël të krimeve të tilla. Vetëm pesë krime të urrejtjes janë regjistruar nga policia në vitin 2015 dhe vetëm dy në vitin 2016 - sipas të dhënave të publikuara nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR)¹. Të dhënat nga burime joqeveritare tregojnë një numër pak më të madh të krimeve të urrejtjes por ende numri është shumë i vogël. Komiteti kombëtar i Helsinkit dhe Misioni i OSBE-së në Shkup i kanë raportuar ODIHR-it gjithsej 3 1 incidente të krimit të urrejtjes për vitin 2015. 13 incidente të tjera të regjistruar nuk u verifikuan si krim i urrejtjes sipas standardeve të evidentimit të OSBE / ODIHR². Për vitin 2016 ata raportuan gjithsej 35 incidente dhe 35 incidente plotësuese që janë të regjistruara por të paverifikuara³. Asnjë OJQ tjetër në Maqedoninë e Veriut nuk ka mbledhur dhe publikuar të dhëna për krimet e urrejtjes .

Duke pasur parasysh atë që dihet për shtrirjen e viktimizimit nga krimi i urrejtjes në vendet e tjera evropiane, siç tregohet nga studimi i EU-MIDIS II dhe i referuar në këtë raport,⁴ përhapja e vërtetë e krimeve të urrejtjes në Maqedoninë e Veriut ka gjasa të jetë e keq llogaritur në të dhënat administrative të publikuara për vendin - ashtu si do të dëshmohej nga ky raport.

Për më tepër, Maqedonia Veriore ka një histori të gjatë të polarizimit dhe tensioneve etnike midis pjesëtarëve të bashkësive shqiptare dhe maqedonase⁵. Një polarizim i tillë siguron gjithashtu një terren pjellor për krimin e urrejtjes.

Hulumtimi kishte për qëllim të ofrojë një pasqyrë më të plotë të viktimizimit nga krimi i urrejtjes në Maqedoninë e Veriut dhe efektet e tij se sa është ofruar deri më sot, si dhe të identifikohet shkalla e mos denoncimit të incidenteve nga krimi i urrejtjes nëpërmjet kryerjes së hulumtimeve në një sërë komunitetesh të tjera të identitetit shoqëror shumicë dhe pakicë në bazë të përkatësisë etnike, religjionit, orientimit seksual, aftësisë së kufizuar dhe bindjeve politike.

¹ <http://hatecrime.osce.org/former-yugoslav-republic-macedonia?year=2015> dhe <http://hatecrime.osce.org/former-yugoslav-republic-macedonia?year=2016>

² Shih: Komiteti i Helsinkit (2016) Raporti Vjetor për Krimet e Urrejtjes në vitin 2015, Shkup: Komiteti i Helsinkit, faqja 97.

³ Shih: Komiteti i Helsinkit (2015) Raporti Vjetor për Krimet e Urrejtjes në vitin 2016, Shkup: Komiteti i Helsinkit, faqja 121.

⁴ Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA) (2017) EU-MIDIS II: Second European Union minorities and discrimination survey, Vienna: European Union Agency for Fundamental Rights.

⁵ cf. Koinova, M. (2013) Ethnonationalist Conflict in Postcommunist States: Varieties of Governance in Bulgaria, Macedonia, and Kosovo, Philadelphia, PA: University of Pennsylvania Press.

Qëllimi ishte të ofrohej dëshmi për nevojën e zhvillimit të masave efektive që do të reagojnë ndaj problemit dhe do të luftojnë kundër tij, që do të udhëzojnë politikën dhe strategjinë e synuar nga autoritetet kombëtare dhe lokale dhe do mbështesin organizatat e shoqërisë civile në punën e tyre përfaqësuese ⁶.

STRUKTURA E RAPORTIT

Raporti është paraqitur në pesë kapituj. Pas pjesës hyrëse, do të prezantohen disa çështje kyçe metodologjike për hartimin e hulumtimit dhe analizën e të dhënave për të informuar interpretimin e rezultateve të studimit. Rezultatet pastaj paraqiten në të katër kapitujt: përvoja me krimin e urrejtjes; autorët e krimit të urrejtjes; veprimi i policisë pas kryerjes së krimit të urrejtjes dhe efekti i krimeve të urrejtjes. Aty ku është e mundur, bëhen krahasime me evidencën ndërkombëtare për viktimizimin nga krimi i urrejtjes, kryesisht me rezultatet nga hulumtimi EU-MIDIS II⁷

⁶ OSBE ODIHR propozon që: „Mjetet që masin krimet e pa denoncuara të urrejtjes dhe ndikimi i tyre ndaj viktimave mund të japin një tregues më të mirë të vëllimit të vërtetë të krimeve të urrejtjes, si dhe informacione të vlefshme për ndikimin e krimeve të urrejtjes ndaj viktimave. Ata mund të identifikojnë komunitetet specifike në rrezik dhe të japin informacion rreth ndryshimit të mënyrave të dhunës. Ato mund të ndihmojnë në vlerësimin e nivelit të besimit të komunitetit në polici dhe agjencitë tjera të drejtësisë penale. Të gjitha këto njohuri mund të ndihmojnë në përmirësimin e planifikimit, veprimit parandalues dhe reagimit. „Mbledhja e të Dhënave të Krimit në Mbledhjen e të Dhënave dhe Mekanizmat e Monitorimit” A Practical Guide, (2014: Warsaw: OSCE/ODIHR, page 33).

⁷ Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA) (2017) EU-MIDIS II Second European Union minorities and discrimination survey, Vienna: European Union Agency for Fundamental Rights

2. DIZAJNI I HULUMTIMIT

DIZAJNI I MOSTRËS

Duke pasur parasysh qëllimin për të siguruar një pasqyrë më të plotë të viktimizimit nga krimi i urrejtjes në Maqedoninë e Veriut, në krahasim me të dhënat administrative të publikuara më parë dhe të dhënat e OJQ-ve, ky hulumtim u hartua për të maksimizuar potencialin për të përjetuar përvojën e viktimave të krimit të urrejtjes.⁸

Për hulumtim u përdor një dizajn i modelit të kuotave. Në mungesë të kornizave të besueshme të marrjes së mostrave për përzgjedhjen e një mostre të rastësishme të popullsisë në Maqedoninë e Veriut - siç janë skedarët e adresave të kodit postar - si dhe në mungesë të informatave të përditësuara nga regjistrimi për zonën lokale për t'u mbështetur një teknikë e zgjedhjes së rastësishme e mostrave, siç është shëtitja e rastësishme, përdorimi i mundshëm i dizajnit të hulumtimeve të bazuar në mostrat e rastësishme të të anketuarve ishte i kufizuar. Përdorimi potencial i një teknikë të zgjedhjes së mostrave gati-rastësore, siç është kampionimi i drejtuar nga ana e të anketuarve, ishte gjithashtu i kufizuar nga kostoja e lartë.-një kosto që rritet dukshëm kur kërkon të anketojë një sërë komunitetesh të ndryshme të identitetit social të shumicës dhe të minoritetit.

PËRZGJEDHJA E MOSTRËS

Përzgjedhja e mostrës është projektuar për të maksimizuar potencialin për të kapur përvojën e viktimizimit të krimit të urrejtjes⁹. Duke e kuptuar se normat e krimeve të urrejtjes janë më të mëdha në zonat me laramani më të madhe të popullsisë¹⁰, mostra është përzgjedhur nga komunat në të cilat popullata etnike maqedonase, sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2002, nuk ishte më e madh se 77% dhe jo më pak se 23% e popullsisë së përgjithshme të komunës. Tetëmbëdhjetë komuna i plotësuan këtë kriter¹¹. Për të minimizuar anshmërinë potenciale të përzgjedhjes, mostra në secilën komunë është përzgjedhur sipas kuotave në bazë të përbërjes së grupeve etnike, gjinisë dhe moshës në komunat.

Madhësia e mostrës totale të të anketuarve të zgjedhur në secilën komunë ishte proporcionale me madhësinë e popullsisë së përgjithshme të secilës komunë si përqindje e popullsisë së përgjithshme për të gjitha tetëmbëdhjetë komunat e kombinuara. Mostra totale për secilën komunë u nda proporcionalisht sipas përbërjes etnike të komunës.¹²

⁸ Hulumtimi i dizajnuar nga Magdalena Świder dhe Paul Iganski.

⁹ Manuali i Kombeve të Bashkuara mbi Hulumtimet mbi Viktimizimin thotë se "zgjedhje e mostave të kuotave është një mjet i vlefshëm kur zhvillohet një studim pilot i viktimizimit" Shih: UNODC-UNECE (2014) Manual on Victimization Surveys, Geneva, United Nations, page 36: https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/Crime-statistics/Manual_on_Victimization_surveys_2009_web.pdf

¹⁰ Iganski, P. (2007) Hate Crime and the City, Bristol, UK Policy Press. (Shih Kapitullin 3: "The spatial dynamics of everyday hate crime", Bristol: Policy Press, pages 45-71.

¹¹ Shih:Shtojca 1

¹² Shih: Shtojca 2. Përzgjedhja e të anketuarve vllëh dhe boshnjakë është përjashtim pasi që mostrat më të mëdha jo proporcionale u përzgjedhën për të arritur një minimum prej 30 të anketuarve në total nga secili grup - numri minimal i përdorur në mënyrë konvencionale për analizë

Për mostrën e përgjithshme të zgjedhur në secilën komunë, tre të katërtat ishin meshkuj dhe një e katërta femra. Qëllimi i këtij mbi përfaqësimi të meshkujve ishte të përftohej një fotografi gjithëpërfshirëse e viktimizimit nga krimi, duke qenë se meshkujt kanë më shumë gjasa të jenë autorë dhe viktimë të krimit të dhunshëm në vende publike dhe vepra të rendit publik - llojet e krimeve që shpesh rëndohen si krime të urrejtjes sesa femrat.

Në mostrën e përzgjedhur në secilën komunë gjithashtu ka mbi përfaqësim të moshave më të reja në krahasim me grupet e moshave më të vjetra, me qëllim që të kapet një fotografi sa më gjithëpërfshirëse e viktimizimit nga krimi, duke qenë se meshkujt e moshës 16-24 vjeç janë më të prirë të jenë viktimë të krimit të dhunshëm në vende publike me një normë rënie të viktimizimit me moshën. Në secilën komunë për hulumtimin u përzgjedhën mostër dy herë me e madhe se proporcioni i popullatës kombëtare të moshës prej 15-19 vjet, 20-24 vjet dhe 25-29 vjet; shkallë e barabartë me shkallën e popullsisë nacionale prej 30-39 vjet si dhe gjysma e shkallës nacionale të popullatës të përzgjedhur për grupmoshat më të vjetra.

MADHËSIA E MOSTRËS

Intervistuesit iu qasën 1733 personave: 223 persona refuzuan të intervistoheshin (14.8% e të gjithë atyre që iu afruan) kurse 1510 të anketuar të moshës 15 vjeçare e lart morën pjesë në hulumtim duke plotësuar intervistën. Ky numër është brenda intervalit konvencional të numrit të të anketuarve të përzgjedhur për hulumtime të opinionit dhe hulumtimin e tregut.

PUNA NË TERREN

Puna në terren u krye nga agjencia kombëtare e kërkimit, BRIMA¹³ duke përdorur 43 intervistues që flasin gjuhën maqedonase dhe gjuhën shqipe me përvojë paraprake në kryerje të intervistave për hulumtime. Duke pasur parasysh natyrën e ndjeshme të disa pyetjeve të hulumtimit, u kryen vetë-intervista me tabletë (tablet assisted self-interviews, TASI), në të cilën të anketuarit plotësuan një pyetësor të paracaktuar me një tabelë të ofruar nga intervistuesi, me ndihmën e intervistuesit sipas nevojës. Pyetësori u ofrua në gjuhën maqedonase ose në gjuhën shqipe. Intervistuesit ishin të pranishëm për t'u përgjigjur në çdo pyetje nga të anketuarit lidhur me çfarëdo sqarimi të nevojshëm rreth formulimit të pyetjeve. Intervistat u zhvilluan herët në mbrëmje dhe gjatë fundjavës për t'u përfshirë të anketuarit e mundshëm që gjatë ditës ishin në punë, në shkollë ose në fakultet.

Të anketuarit u përzgjedhën në vende publike, në vende të zgjedhura për të arritur një përfshirje të tërë të popullsisë - afër stacioneve hekurudhore, stacioneve të autobusëve, postës, qendrave mjekësore dhe spitaleve, qendrave tregtare dhe kinemave. Përpara kryerjes së punës në terren, u krye pilotimi i rekrutimit të të anketuarve dhe plotësimi i pyetësorit nën të njëjtat kushte si ishte planifikuar për sondazhin.

PARAQITJA E REZULTATEVE TË HULUMTIMIT NË KËTË RAPORT

Të gjitha rezultatet e paraqitura janë rezultate të ponderuara - pavarësisht nga paraqitja e akuzave për krime të përjetuara. Ponderimi u aplikua për të rregulluar rezultatet sipas parametrave të popullsisë për grupin etnik, gjininë dhe përbërjen e moshës së popullsisë kombëtare sipas regjistrimit të vitit 2002. Siç është konvencionale kur raportohen gjetjet e mostrës së sondazhit,

¹³ Shih: <http://www.brima.com.mk/eng/index.html>

përqindjet e ponderuara dhe numrat e ponderuar të të anketuarve nga të cilët rrjedhin përqindjet, janë paraqitur për rezultatet e raportuara.

INTERPRETIMI I REZULTATEVE TË HULUMTIMIT NË KËTË RAPORT

Edhe pse përzgjedhja dhe ponderimi i mëpasshëm i mostrës së hulumtimit synon të përputhet me popullsinë nga e cila është tërhequr në aspekt të përbërjes etnike të grupit, moshës dhe gjinisë, përdorimi i zgjedhjes së mostrës së kuotave e jo sipas zgjedhjes së rastit pengon përgjithësimin e rezultateve të hulumtimit përtej të anketuarit.

Rrjedhimisht, ky raport nuk ofron konkluzione për një popullsi më të gjerë përtej mostrës së hulumtimit. Dallimet e vërejtura në mes të nën-grupeve të mostrës –si p.sh. ndërmjet viktimave të krimit të urrejtjes dhe viktimave të krimeve të tjera, midis grupeve etnike, midis grupmoshave dhe midis femrave dhe meshkujve - janë dallimet faktike për mostrën.

Për të ndihmuar në interpretimin e dallimeve të vërejtura, disa konventa ndiqen duke u bazuar në raportimin e rezultateve nga anketat sipas zgjedhjes së rastit. Pasi që rezultatet në bazë të një numri të vogël të përgjigjeve në një hulumtim janë më pak të besueshme, në këtë raport është adoptuar praktika e përdorur nga Agjencia e të Drejtave Themelore të BE-së (FRA) në raportet mbi vëzhgimin EU-MIDIS II:

- Rezultatet e bazuara në 20 deri 49 numra të ponderuar të të anketuarve në një grup total ose në bazë të fushave me më pak se 20 të anketuar të ponderuar janë shënuar në kllapa
- Rezultatet e bazuara në më pak se 20 të anketuar të paponduar në një grup total nuk janë paraqitur (me pak përjashtime).

Duke pasur parasysh se rezultatet e hulumtimit rrjedhin nga një mostër e kuotave, e jo me zgjedhje të rastit, testet e rëndësishme statistikore nuk janë të dhënë në raportet për rezultatet sepse supozimi kyç pas testimit të rëndësishëm është që rezultatet të bazohen në një mostër të rastësishme të të anketuarve. Megjithatë, për të ndihmuar në interpretimin e dallimeve të vogla të vëzhguara në mes të nën-grupeve të të anketuarve ose kategorive të të dhënave në rezultatet e paraqitura, aty ku komentohen dallimet e tilla, dhe ku nevojitet kujdes gjatë interpretimit, përdoret një yll për të treguar se dallimi i vërejtur nuk do të ishte i rëndësishëm nga ana statistikore nëse rezultatet janë nxjerrë nga një mostër e rastit: nënkupton një nivel më të ulët nga niveli konvencional i besimit se rezultatet nuk mund të kishin ndodhur rastësisht për shkak të karakteristikave të përzgjedhjes së mostrës në vend të dallimeve reale.

3. PËRVOJA ME KRIMIN NË PËRGGJITHËSI

Për të vendosur kontekstin për paraqitjen e gjetjeve të hulumtimit në lidhje me krimet e urrejtjes të përjetuara nga të anketuarit, është e udhës të përshkruhen shkurtimisht rezultatet e hulumtimit në lidhje me përvojat e të anketuarve me çdo lloj krimi në përgjithësi.

NUMËRIMI I VIKTIMITIZIMIT NGA KRIMI I URREJTJES

Për të kuptuar përvojën e perceptuar të krimit nga të anketuarit, pyetjet e hulumtimit u përqendruan në 11 kategori të ndryshme të krimit të përfshira me Kodin Penal të Maqedonisë së Veriut. Ndërsa ato nuk përfshijnë të gjitha krimet e përcaktuara me Kodin Penal, një grup pune i Ministrisë së Drejtësisë propozoi ndryshime në Kodin Penal për secilën prej këtyre kategorive të krimit për të inkorporuar zgjerimin e ndëshkimeve në rastet e krimeve të urrejtjes¹⁴.

Pyetjet që kanë të bëjnë me tetë kategoritë e krimit (shih Figurën 1) të parashtruara për krimin e përjetuar drejtpërsëdrejti nga të anketuarit në hulumtim. Tetë kategoritë e kombinuara ofrojnë një numër të besueshëm të viktimizimit nga krimi. Ato gjithashtu ofrojnë një krahasim të dobishëm me rezultatet e hulumtimeve të viktimizimit nga krimi nga disa vende të tjera, pasi i mbulojnë klasifikimet kryesore të krimit të përdorur në nivel ndërkombëtar. Është, megjithatë, një numërim minimal duke pasur parasysh se nuk përfshin çdo kategori të krimit në Kodin Penal të Maqedonisë së Veriut.¹⁵

Duke përdorur numrin minimal të viktimizimit nga krimi, vetëm një nga 6 të anketuar (17,5%) ka pasur përvojë me krim në 12 muajt para hulumtimit të realizuar.


LLOJET E KRIMEVE TË PËRJETUARA

Lloj më i zakonshëm i krimit të përjetuar nga të anketuarit ka të bëjë me vjedhje ose grabitje: i përjetuar pothuajse nga një e dhjeta (9.2%) e të gjithë të anketuarve në 12 muajt para hulumtimit (Figura 1).

¹⁴ Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut rekomandon që: Ku të jetë e mundshme, hulumtimet e viktimizeve të trajtojnë të njëjtat motive dhe lloje të krimeve të kapura nga statistikat zyrtare. Kjo lejon krahasime kuptimplotë midis hulumtimeve dhe të dhënave të regjistruara nga agjencitë e drejtësisë penale. „Mbledhja e të Dhënave të Krimit të Hagës dhe Mekanizmat e Monitorimit.” Hate Crime Data-Collection and Monitoring Mechanisms. A Practical Guide, (2014: Warsaw: OSCE/ODIHR, page 34).

¹⁵ Pyetjet për tre nga kategoritë e krimit, sipas dizajnit, ishin potencialisht gjithëpërfshirës në aspektin e përvojës së krimit të kapur dhe kategoritë e krimit gjithashtu nuk përfshihen në përgjithësi në anketat e viktimizimit nga krimi në nivel ndërkombëtar. Pyetjet e bëra për dy nga kategoritë e krimit potencialisht kapin përvojën e njerëzve të prekur nga krimet në fjalë, por që nuk ishin në shënjestër të drejtpërdrejtë: „A jeni prekur nga dikush që përdhosë një varr gjatë vitit të kaluar?” Dhe „A jeni prekur nga dikush që parandalon ose shqetëson një tubim publik gjatë vitit të kaluar? „. Përveç kësaj, një pyetje në lidhje me refuzimin e ndihmës mjekësore nuk pyet se refuzimi ishte nga një person i autorizuar dhe i aftë për të ofruar ndihmë mjekësore.

Figura 1: Llojet e krimeve të përjetuara gjatë vitit të kaluar



Të anketuarit që u përgjigjen me “po” në...

- a) Pyetja CV1: “A ka vjedhur dikush nga prona juaj apo ju ka plaçkitur gjatë vitit të kaluar?”
- b) Pyetja CV3: “A ju ka fyer ose ju ka sulmuar me fjalë dikush gjatë vitit të kaluar?”
- c) Pyetja CV18: “A ka dëmtuar dikush pronën tuaj gjatë vitit të kaluar?”
- d) Pyetja CV2: “A ka kërcënuar dikush sigurinë tuaj gjatë vitit të kaluar?”
- e) Pyetja CV4: “A ju ka sulmuar dikush fizikisht (duke përjashtuar plaçkitjen) pa shkaktuar lëndime trupore gjatë vitit të kaluar?”
- f) Pyetja CV5: “A ju ka sulmuar dikush fizikisht (duke përjashtuar plaçkitjen) duke shkaktuar lëndime trupore gjatë vitit të kaluar?”
- g) Pyetja CV7: “A ju ka privuar dikush nga liritë tuaja ilegalisht gjatë vitit të kaluar?”
- h) Pyetja CV6: “A ju ka sulmuar dikush seksualisht ose a ju ka përdhunuar gjatë vitit të kaluar?”

Fyerjet dhe sulmi verbal janë lloji i dytë më i zakonshëm (6.2%) i krimit të përjetuar. Numri minimal i përdorur përfshin vetëm fyerjet ose sulmet verbale të klasifikuara si krime në Kodin penal, të cilat janë ato të kryera tërësisht ose pjesërisht për shkak të përkatësisë etnike, racore, kombëtare ose fetare të viktimave, bindjet e tyre politike, për shkak të gjinisë së tyre, orientimit seksual ose identitetit gjinor, ose për shkak të gjendjes fizike ose shëndetit mendor që mund të kenë.


Nëse shtohen fyerjet jo-penale të raportuara nga të anketuarit, atëherë më shumë se një e dhjeta (11.7%) e të gjithë të anketuarve raportojnë se i janë nënshtruar një forme të fyerjes ose sulmit verbal në 12 muajt para hulumtimit.

Veçanërisht, shumë pak të anketuar kanë raportuar se janë sulmuar fizikisht, me (0.9%) ose pa (1.6%) dëmtime. Dëshmitë e anketës së krimit nga vendet e tjera gjithashtu tregojnë se vetëm përqindje të vogla të të anketuarve raportojnë sulme. Për shembull, vetëm 2.7% e të anketuarve në Hulumtimin e krimit në Suedi 2017 kanë deklaruar se kanë qenë viktimë e sulmit.¹⁶

Disa të anketuar kanë përjetuar më shumë se një krim, dhe disa në më shumë se një rast. Kur numrat e ponderuar janë mbledhur së bashku, ka rezultuar se 783 krime janë përjetuar në total nga 1.510 të anketuar në 12 muajt para hulumtimit (Figura 2). Kategoria më e madhe e krimit – që përfshin më shumë se një të katërtën e të gjitha krimeve (26.9%) – kishte të bëjë me vjedhje të pronës ose grabitje. Fyerjet ose sulmet verbale përbënin pak më shumë se një të katërtën e të gjitha krimeve. Sulmet fizike, me ose pa dëmtim, përbënin së bashku një pjesë relativisht të vogël - rreth një në shtatë (14.0%) - të të gjitha krimeve.

¹⁶ Këshilli Kombëtar Suedez për Parandalimin e Krimit (Brå) (2018) Swedish Crime Survey 2017, Stokholm: Brå, faqe 7

Figura 2: Numri i veprave kriminele të përjetuara në vitin e fundit sipas llojit të krimit



Numri total (i paponderuar) i krimeve të raportuara nga të anketuarit = 783

Sa herë?

Pyetje: a CV3a; b CV1a; c CV9a; d CV11a; e CV2a; f CV8a; g CV10a; h CV11a; i CV5a; j CV7a; k CV6a.

4. PËRVOJA ME KRIMIN E URREJTJES

Për secilën kategori të krimit të përfshirë në hulumtime, të anketuarit u pyetën - nëse ata kishin qenë viktimë e krimit në 12 muajt e fundit - a mendonin se incidenti ose ndonjë incident ka ndodhur pjesërisht ose tërësisht për shkak të përkatësisë së tyre etnike, racore apo prejardhjes kombëtare, besimit fetar dhe bindjeve të tyre politike. Nëse të anketuarit më herët në intervistë kishin thënë se orientimi i tyre seksual ishte ndryshe nga „heteroseksual”, u pyetën nëse mendonin se incidenti kishte ndodhur për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor. Gjithashtu, nëse në intervistë kishin deklaruar se kanë ndonjë problem shëndetësor fizik ose mendor ose sëmundje që zgjasin ose pritet të zgjasin 12 muaj ose më shumë, ata u pyetën nëse incidenti ishte i lidhur me atë gjendje apo sëmundje. Të anketuarit janë pyetur gjithashtu për krimin më të rëndë që kanë thënë se kishin përjetuar në 12 muajt para hulumtimit (p.sh. „A mendoni se [ky incident / ndonjë nga këto incidente] në 12 muajt e fundit ka ndodhur pjesërisht apo tërësisht sepse jeni grua?”).

Krimet e raportuara nga të anketuarit të cilët u përgjigjën me „po” ndaj ndonjërës prej këtyre pyetjeve u konsideruan si krime të urrejtjes¹⁷.

Thuajse, 1 nga 10 të anketuar (9.1%) ka thënë se kanë pasur përvojë me krim në 12 muajt para hulumtimit. Duke përdorur numrat e paponduar, 165 të anketuar kanë raportuar se kanë qenë viktimë e së paku një krimi të urrejtjes gjatë vitit të kaluar. Ky numër është në kontrast të madh me numrin e krimeve të urrejtjes të raportuara zyrtarisht nga Maqedonia e Veriut, si dhe numrin e raportuar nga Komiteti i Helsinkit në Zyrën e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. Kontrasti është edhe më i fortë kur dihet se 165 personat që kanë përjetuar krime të urrejtjes ishin vetëm një pjesë e vogël e popullsisë që mori pjesë në hulumtim.

Krahasimet ndërkombëtare të shkallës së viktimizimit nga krimi i urrejtjes mund të mos jenë të besueshme, meqenëse nuk ka përkufizim standard që përdoret për krimin e urrejtjes. Megjithatë, sa për krahasim, Hulumtimi për krimin në Suedi 2016 vlerësoi se në Suedi në vitin 2015 2.8% e popullsisë së moshës 16-79 vjeçare kanë qenë viktimë të krimeve ksenofobie, anti-fetare ose krime homofobike të urrejtjes¹⁸. Sidoqoftë, kjo është një masë më konservatore kur krahasohet me studimin e krimeve të urrejtjes, pasi Hulumtimi për krimin në Suedi nuk ka përmbajtur pyetje për krimet që të anketuarit besonin se kishin ndodhur për shkak të besimeve të tyre politike, ndonjë paaftësi që mund të kishin, ose për shkak se bëhet fjalë për grua.

Një masë shumë më pak konservatore dhe shumë më përfshirëse është përdorur në hulumtimin e EU-MIDIS II-it gjatë numërimit të përvojës së ngacmimeve të motivuar nga urrejtja që të anketuarit i kanë perceptuar si krime që kanë të bëjnë me origjinën e tyre etnike ose emigrante. Hulumtimi u përqendrua në pesë lloje të ngacmimeve: komentet personale ofenduese ose kërcënuese; kërcënimet personale për dhunë; gjeste ofenduese ose ngulje sysh në mënyrë të papërshtatshme; mesazhe fyese ose kërcënuese me e-mail ose SMS dhe komentet fyese të bëra në lidhje me ta në internet. Kjo masë e ngacmimit shtrihet tej kategorive të krimit të përdorura në këtë hulumtim për të kapur përvojën me krimin e urrejtjes në Maqedoninë e Veriut. Veçanërisht, një në katër (24%) e të anketuarve në hulumtimin EU-MIDIS II kanë thënë se kanë përjetuar ngacmime me motive urrejtjeje në 12 muajt para hulumtimit¹⁹.


¹⁷ Grupi punues i Ministrisë së Drejtësisë propozoi që: „Një krim i urrejtjes, siç përshkruhet me dispozitat e këtij ligji, është një vepër penale kundër një personi ose subjekti juridik ose pronës që ka lidhje me të, që kryhet tërësisht ose pjesërisht për shkak të faktit aktual ose karakteristikat e supozuara të personit që i referohet racës, ngjyrës së lëkurës, kombësisë, origjinës etnike, fesë ose besimit, aftësisë së kufizuar mendore ose fizike, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, përkatësisë politike apo që i përkasin një grupi të marginalizuar ... (Paragrafi 23 neni 32)

¹⁸ Këshilli Kombëtar Suedez për Parandalimin e Krimit (Brå) (2018) Hate Crime 2016, Stokholm: Brå, faqe 8

¹⁹ Shih: Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA) (2017) EU-MIDIS II: Second European Union minorities and discrimination survey, Vienna: European Union Agency for Fundamental Rights, faqe 58.

LLOJET E KRIMEVE TË URREJTJES TË PËRJETUARA

Figura 3: Numri i të anketuarve që kanë përjetuar krim të urrejtjes gjatë vitit të kaluar sipas llojit të krimit



Të anketuarit që janë përgjigjur me "po" në CV1c, CV1d, CV1e, CV1f, CV1g, CV2c, CV2d, CV2e, CV2f, CV2g, CV3c, CV3d, CV3e, CV3f, CV3g, CV4c, CV4d, CV4e, CV4f, CV4g, CV5c, CV5d, CV5e, CV5f, CV5g, CV6c, CV6d, CV6e, CV6f, CV6g, CV7c, CV7d, CV7e, CV7f, CV7g, CV8c, CV8d, CV8e, CV8f, CV8g, MS5 dhe me "po" në...

- a) Pyetja CV3: "A ju ka fyer ose ju ka sulmuar me fjalë dikush gjatë vitit të kaluar?"
- b) Pyetja CV1: "A ka vjedhur dikush nga prona juaj apo ju ka plaçkitur gjatë vitit të kaluar?"
- c) Pyetja CV18: "A ka dëmtuar dikush pronën tuaj gjatë vitit të kaluar?"
- d) Pyetja CV2: "A ka kërcënuar dikush sigurinë tuaj gjatë vitit të kaluar?"
- e) Pyetja CV4: "A ju ka sulmuar dikush fizikisht (duke përjashtuar plaçkitjen) pa shkaktuar lëndime trupore gjatë vitit të kaluar?"
- f) Pyetja CV5: "A ju ka sulmuar dikush fizikisht (duke përjashtuar plaçkitjen) duke shkaktuar lëndime trupore gjatë vitit të kaluar?"
- g) Pyetja CV7: "A ju ka privuar dikush nga liritë tuaja ilegalisht gjatë vitit të kaluar?"
- h) Pyetja CV6: "A ju ka sulmuar dikush seksualisht ose a ju ka përdhunuar gjatë vitit të kaluar?"

Lloji më i zakonshëm i krimeve të urrejtjes përfshinte sulme verbale. Pavarësisht nga treguesit nga të dhënat e OJQ-ve se shumica e krimeve të urrejtjes përfshijnë edhe lëndime trupore²⁰, shumë pak krime të urrejtjes të raportuara në hulumtim kanë përfshirë sulmet fizike me ose pa dëmtim si pasojë.


Nëse përvoja e çdo të anketuari që përjeton një krim të caktuar llogaritet vetëm si një krim, atëherë gjithsej 222 krime të urrejtjes qenë regjistruar në hulumtim nga gjithsej 1510 të anketuar.

²⁰ Shih: Komiteti i Helsinkit (2016) Raporti Vjetor për Krimet e Urrejtjes në vitin 2016, Shkup: Komiteti i Helsinkit, faqja 122.

VIKTIMIZIMI NGA KRIMI SIPAS KOMUNAVE

Duke pasur parasysh numrin e vogël të të anketuarve ($n < 50$) në më shumë se gjysmën e komunave, nuk është e mundur të bëhen krahasime të besueshme të përqindjeve të viktimizimit nga krimi të raportuar në të gjitha tetëmbëdhjetë komunat e përzgjedhura për hulumtim. Megjithatë, është evidente (figura 4) se përqindja e viktimizimit nga krimi për të anketuarit nga Kërçova (42.3%) dhe Gazi Baba (28.8%) janë shumë më të larta se viktimizimi nga krimi për të gjitha komunat e kombinuara (17.4). Përqindja për Tetovën (11.1%) dhe Strugën (10.9%) janë nën nivelin e përgjithshëm të viktimizimit nga krimi.

Figura 4: Viktimizimi nga krimi sipas komunës^a



n:


Kërçovë= 83; Mavrovë& Rotushë = 23; Gazi Babë = 194; Jegunoc = 28; Petrovec = 22; Bërvenicë= 42; Butel = 95; TË GJITHË=1510; Çair= 171; Kumanovë = 278; Sopishte = 15; Tetovë = 233; Strugë = 167; Çuçer Sandevo= 22; Resnjë= 44; Dollnen = 36; Çashkë= 20; Krushevë = 26; Zelenikovë = 11;

^a Ndryshorja (Variabla) e kodit të intervistuesit: 'Komuna'

VIKTIMIZIMI NGA KRIMI I URREJTJES SIPAS KOMUNAVE

Është e qartë se përqindja e viktimizimit nga krimi i urrejtjes për komunitetet e Kërçovës dhe Gazi Babës ishin shumë më të larta se përqindja e viktimizimit nga krimi i urrejtjes për tërë mostrën e të anketuarve në hulumtim. Përqindja për komunitetet e Tetovës dhe Strugës ishin afërsisht gjysma e përqindjes për të gjithë mostrën e të anketuarve në hulumtim.

Figura 5: Viktimizimi nga krimi sipas komunës^a



n:

Kërçovë= 83; Mavrovë & Rotush = 23; Gazi Babë = 194; Jegunoc = 28; Petrovec = 22; Brvenicë= 42; Butel = 95; ALL=1510; Çair= 171; Kumanovë = 278; Sopishte = 15; Tetovë = 233; Strugë = 167; Çuçer Sandevë= 22; Resnjë= 44; Dollnen = 36; Çashkë= 20; Krushevë= 26; Zelenikovë = 11;

^a Ndryshorja (Variabla) e kodit të intervistuesit: 'Komuna'

Banorët urbanë kanë më shumë gjasa se banorët ruralë të raportojnë viktimizim nga krimi i urrejtjes (urban = 10.2%: rural = 7.5%).*

5. KRIMI DHE VIKTIMIZIMI NGA KRIMI I URREJTJES SIPAS KARAKTERISTIKAVE TË VIKTIMAVE

GJINIA DHE VIKTIMIZIMI NGA KRIMI

Të anketuarit meshkuj kishin pak më shumë gjasa se femrat që të raportonin se kishin qenë viktimë e krimit në 12 muajt para hulumtimit (19.0% e meshkujve: 16.0% e femrave). Dallimi midis niveleve të viktimizimit nga krimi për meshkujt dhe femrat është më i madh në zonat urbane (22.0% e meshkujve: 16.8% e femrave) dhe më i vogël në zonat rurale (15.1% e meshkujve: 14.6% e femrave). * Ndërveprimi i moshës dhe gjinisë në viktimizimin nga krimi diskutohet më poshtë në gjetjet mbi moshën dhe viktimizimin nga krimi.


GJINIA DHE VIKTIMIZIMI NGA KRIMI I URREJTJES

Përqindje shumë të ngjashme të të anketuarve meshkuj dhe femra (9.3% e meshkujve: 8.9% e femrave) kanë raportuar se kanë qenë viktimë e krimeve të urrejtjes në 12 muajt para hulumtimit. * Duhet theksuar se sondazhi i EU-MIDIS II-it i cili u përqendrua në ngacmimin në bazë të prejardhjes etnike ose origjinës emigrante të të anketuarve gjithashtu nuk gjeti dallime gjinore në shkallën e përgjithshme të viktimizimit.²¹ Ndërveprimi i moshës dhe gjinisë në viktimizimin nga krimi i urrejtjes diskutohet më poshtë në gjetjet mbi moshën dhe viktimizimin nga krimi.

MOSHA DHE VIKTIMIZIMI NGA KRIMI


Të anketuarit më të rinj kishin më shumë gjasa që të raportonin se kishin qenë viktimë e krimeve të urrejtjes në 12 muajt para hulumtimit sesa të anketuarit më të moshuar.

²¹ Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA) (2017) EU-MIDIS II Second European Union minorities and discrimination survey, Vienna: European Union Agency for Fundamental Rights, faqe 58.

Figura 6: Moshë dhe përvoja me viktimizimin nga krimi^a

MOSHA DHE VIKTIMIZIMI NGA KRIMI I URREJTJES

Ngjashëm, në rastin e viktimizimit nga krimi i urrejtjes, të anketuarit më të rinj kishin më shumë gjasa që të raportonin se kishin qenë viktimë e krimeve të urrejtjes në 12 muajt para hulumtimit sesa të anketuarit më të moshuar (figura 7). Ky konstatim është gjithashtu në përputhje me sondazhin e EU-MIDIS II-it i cili tregon se grupmosha më e re ka raportuar shkallën më të lartë të ngacmimit, gjatë së cilës përhapje zvogëlohet me rritjen e moshës²². Por është gjithashtu e qartë se viktimizimi nga krimi i urrejtjes ndodh përgjatë tërë spektrit të moshave të të anketuarve. Përkundër treguesve nga të dhënat e OJQ-ve se shumica e viktimave të krimeve të urrejtjes janë të mitur²³, gjashtë nga dhjetë (62.8%) viktimë të krimeve të urrejtjes në hulumtim ishin të moshës 30 vjeçare e më lartë.

Figura 7: Moshë dhe përvoja me viktimizimin nga krimi i urrejtjes^a


²² Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA) (2017) EU-MIDIS II Second European Union minorities and discrimination survey, Vienna: European Union Agency for Fundamental Rights, faqe 60.

²³ Shih: Komiteti i Helsinkit (2016) Raporti Vjetor për Krimet e Urrejtjes në vitin 2016, Shkup: Komiteti i Helsinkit, faqja 124.

PËRKATËSIA ETNIKE DHE VIKTIMIZIMI NGA KRIMI

Të anketuarit romë raportuan shkallën më të lartë të viktimizimit nga krimi i urrejtjes në 12 muajt para hulumtimit (Figura 5)²⁴. Të anketuarit, pjesëtarë të bashkësisë shqiptare dhe vllahë si grupe kanë raportuar shkallën më të ulët të viktimizimit nga krimi.

Figura 8: Përkatësia etnike dhe përvoja me viktimizimin nga krimi^a



^a Pyetja BG20: "Cili është grupi juaj etnik? Ju lutemi zgjidhni opsionin që më së miri përshkruan grupin ose prejardhjen tuaj etnike."

PËRKATËSIA ETNIKE DHE VIKTIMIZIMI I NGA KRIMI I URREJTJES


Duke pasur parasysh numrin relativisht të vogël të të anketuarve (<50) nga disa grupe etnike, krahasimi më i besueshëm është në mes të anketuarve shqiptarë, maqedonas * dhe turq. Shkalla e viktimizimit nga krimi i urrejtjes për secilën prej këtyre grupeve është pak më e ulët se sa për të gjithë të anketuarit e hulumtimit në total (Figura 9). Nga të gjitha grupet, të anketuarit romë kanë raportuar shkallën më të lartë të viktimizimit nga krimi i urrejtjes brenda 12 muajve përpara hulumtimit²⁵. Është e dukshme se sondazhi EU-MIDIS II në mënyrë të ngjashme ka konstatuar se të anketuarit romë kanë përjetuar shkallën më të lartë të ngacmimit²⁶.

²⁴ Për shkak të numrit të vogël të të anketuarve romë në total (<50) duhet pasur kujdes në nxjerrjen e përfundimeve nga ky konstatim.

²⁵ Megjithatë, për shkak të numrit të vogël të të anketuarve romë në total (<50) duhet pasur kujdes në nxjerrjen e përfundimeve nga ky konstatim.

²⁶ Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA) (2017) EU-MIDIS II: Second European Union minorities and discrimination survey, Vienna: European Union Agency for Fundamental Rights, faqe 58.

Figura 9: Përkatësia etnike dhe përvoja me viktimizimin nga krimi i urrejtjes ^a



^a Pyetja BG20: "Cili është grupi juaj etnik? Ju lutemi zgjidhni opsionin që më së miri përshkruan grupin ose prejardhjen tuaj etnike."

FEJA DHE VIKTIMIZIMI NGA KRIMI

Të anketuarit e krishterë kanë pasur më tepër tendencë të raportojnë se kanë qenë viktimë e krimit në 12 muajt para hulumtimit se të anketuarit myslimanë (20% e të krishterëve: 14.2% e myslimanëve). Përqindjet më të larta të numrit shumë të vogël të të anketuarve nga fetë e tjera (n = 9) ose që preferonin mos të deklarojnë fenë e tyre (n = 16) raportuan se kishin qenë viktimë e krimit por numrat janë tepër të ulët për të bërë krahasim të besueshëm.

FEJA DHE VIKTIMIZIMI NGA KRIMI I URREJTJES

Të anketuarit e krishterë kanë më shumë gjasa të raportojnë se kanë qenë viktimë e krimit të urrejtjes gjatë 12 muajve se të anketuarit myslimanë (9.3% e të krishterëve: 8.4% e myslimanëve).


ORIENTIMI SEKSUAL DHE VIKTIMIZIMI NGA KRIMI

Kur u pyetën për orientimin seksual, shumica e të anketuarve thanë se ishin heteroseksualë. Një numër i konsiderueshëm i të anketuarve (132) thanë se "preferojnë të mos thonë". Disa thanë se ishin biseksual (9), homoseksual (8), aseksual (11), ose "tjetër" (10). Kur u kombinuan si një grup, ata kishin më shumë tendencë të thonë se ishin viktimë e krimit brenda vitit të fundit në krahasim me të anketuarit heteroseksualë dhe të anketuarit të cilët preferonin të mos shprehnin orientimin e tyre seksual (Figura 6)²⁷.

Ajo që është e qartë, megjithatë, është se secili prej tetë të anketuarve që zgjedhën opsionin "homoseksualë" për orientimin e tyre seksual dhe pesë nga nëntë të anketuarit që zgjedhën opsionin "biseksualë", kishin qenë viktimë e një krimi në vitin e fundit.

²⁷ Megjithatë, për shkak të numrit të vogël të të anketuarve në këtë grup të kombinuar (<50) duhet pasur kujdes në nxjerrjen e përfundimeve nga ky konstatim.

Figura 10: Orientimi seksual dhe përvoja me viktimizimin nga krimi ^a




ORIENTIMI SEKSUAL DHE VIKTIMIZIMI NGA KRIMI I URREJTJES

Kur u kombinuan si grup, të anketuarit që u klasifikuan si biseksualë, homoseksualë, aseksualë ose "të tjerë", kishin më shumë gjasa të deklaronin se kishin qenë viktimë e krimeve të urrejtjes në 12 muajt para hulumtimit në krahasim me të anketuarit heteroseksualë dhe ata të anketuar të cilët preferuan të mos deklaronin orientimin e tyre seksual (Figura 11)²⁸.

Veçanërisht, secili prej tetë të anketuarve që përzgjedhën "homoseksualët" për orientimin e tyre seksual, kanë qenë viktimë e një krimi të urrejtjes në 12 muajt para hulumtimit.

Figura 11: Orientimi seksual dhe përvoja me viktimizimin nga krimi i urrejtjes ^a



²⁸ Megjithatë, për shkak të numrit të vogël të të anketuarve në këtë grup të kombinuar (<50) duhet pasur kujdes në nxjerrjen e përfundimeve nga ky konstatim.

PAAFTËSIA DHE VIKTIMIZIMI NGA KRIMI

Tetëmbëdhjetë për qind e të anketuarve (171 të anketuar në total) thanë se kishin një gjendje shëndetësore fizike ose mendore ose sëmundje që zgjasin ose pritet të zgjasin 12 muaj ose më shumë. Ata kishin më shumë gjasa se të anketuarit pa një gjendje të përhershme shëndetësore fizike ose mendore ose sëmundje për të raportuar se kishin qenë viktimë e krimit në 12 muajt para hulumtimit (20.5%: 16.9%).*

PAAFTËSIA E VIKTIMIZIMIT NGA KRIMI I URREJTJES

Ndër ata të anketuar të cilët thanë se kishin një gjendje shëndetësore fizike ose mendore ose sëmundje që zgjasin ose pritet të zgjasin 12 muaj, 11.2% kanë raportuar se kishin përjetuar krime të urrejtjes në 12 muajt para hulumtimit. Kjo është një shkallë pak më e lartë sesa 8.6% e të anketuarve pa aftësi të kufizuara që kishin përjetuar krime të urrejtjes. * Veçanërisht, mbi një në tre të anketuar të cilët thanë se kishin një gjendje afatgjate mendore kanë raportuar se kishin përjetuar krime të urrejtjes në 12 muajt para hulumtimit - shkalla më e lartë e viktimizimit nga krimi i urrejtjes në mesin e të anketuarve me një gjendje fizike ose mendore shëndetësore ose sëmundje që zgjat ose pritet të zgjasë për 12 muaj²⁹.

²⁹ Për shkak të numrit të vogël të të anketuarve të përfshirë (<23) duhet pasur kujdes në nxjerrjen e përfundimeve nga ky konstatim.

6. AUTORËT E KRIMEVE TË URREJTJES

Nga të gjithë të anketuarit që thanë se kishin qenë viktimë e krimit në 12 muajt para hulumtimit u kërkua të specifikonin krimin më të rëndë. Informata më të hollësishme u kërkuan për krime të tilla përtej përvojës së viktimizimit nga krimi. Kjo pjesë e raportit dhe pjesët që pasojnë përqendrohen në krimet më të rënda të paraqitura nga të anketuarit.

**TABELA 1:
AUTORËT E KRIMEVE MË TË RËNDA TË PËRJETUARA NGA TË ANKETUARIT**

	Krimi i urrejtjes %	Krim tjetër %
I panjohur (dikush që nuk e njihnit)	25,2	22,8
Nuk e pash autorin	22,2	28,5
Dikush tjetër nga lagjja	18,8	8,7
Anëtar i familjes	12,3	3,8
Dikush tjetër që e njihni	11,3	10,4
Zyrtar tjetër publik	5,6	3,9
Fqinj	4,5	9,8
Adoleshent ose grup adoleshentësh	4,1	2,8
Dikush nga shkolla ose kolegji	3,5	3,6
Tifozë (huliganë) të futbollit	3,5	0,6
Dikush me të cilin punoni, koleg	3,2	2,3
Klient ose pacient	2,7	2,8
Oficer policie	2,5	0,7
Anëtar i një grupi ekstremist	0,4	0,0
Tjetër	0,4	8,0
<i>I paponderuar n</i>	<i>90</i>	<i>207</i>

Kur u pyetën për autorët e krimeve më të rënda që kishin përjetuar, “të panjohurit” ishin tipi më i zakonshëm i kryerësit - sipas viktimave të krimit të urrejtjes. Megjithatë, një përqindje më e lartë e viktimave të krimeve të urrejtjes dhunuesin e përcaktuan si fqinji, ose dikush tjetër nga lagja, apo dikush tjetër që e njihnin.

Është për t'u theksuar se sipas viktimave, pjesëtarët e grupeve ekstremiste, huliganët e futbollit dhe adoleshentët nuk ishin zakonisht autorët e krimeve të urrejtjes. Më pak se një në 20 viktimave të krimeve të urrejtjes thanë se autorët ishin adoleshentë dhe një përqindje e ngjashme thanë se ishin huliganë të futbollit. Vetëm një viktimë e krimeve të urrejtjes tha se autori i krimit ishte një anëtar i një grupi ekstremist.

7. VEPRIMI I POLICISË PAS KRYERJES SË KRIMIT TË URREJTJES

Pika e parë në të cilën agjencitë e drejtësisë mund t'i përgjigjen akteve të krimit të urrejtjes është kur krimet denoncohen në polici. Megjithatë, është globalisht e njohur se jo të gjitha viktimat e krimit në përgjithësi, dhe jo të gjitha viktimat e krimeve të urrejtjes në veçanti, denoncojnë në polici krimet që i kanë përjetuar. Prandaj, kjo pjesë e raportit paraqet rezultatet e hulumtimit mbi denoncimin e krimeve më të rënda të veçuara nga të anketuarit dhe për ata të anketuar që kanë denoncuar krimet në polici, perceptimet e tyre për mënyrën se si u trajtuan ato.

DENONCIMI I KRIMIT TË URREJTJES NË POLICI

Gjashtë nga dhjetë (60.1%) viktimat të krimit të urrejtjes thanë se krimin nuk e kishin denoncuar në polici, krahasuar me një përqindje më të vogël (50.5%) të të anketuarve për të cilët krimi më i rëndë që ata kishin përjetuar gjatë 12 muajve para hulumtimit nuk ishte krim i urrejtjes. *

**TABELA 2:
ARSYET PËR MOS DENONCIMIN E KRIMIT NË POLICI**

	Krimi i urrejtjes %	Krime të tjera %
Kjo është një ngjarje e rëndomtë / diçka që ndodh	35,0	14,0
Nuk ka besim se policia do të jetë në gjendje të bëjë gjë	33,3	24,6
Është marr vetë me problemin vetë / ndihmë nga miqtë e familjes	20,0	16,3
Shumë banale/nuk ia vlen të denoncohet	17,3	20,7
I shqetësuar për pasojat negative në rast të denoncimit	17,3	16,2
Frika nga kërcënimet nga autorët e krimit nëse denoncohet incidenti	13,1	8,9
Shqetësim / shumë burokraci apo probleme / nuk ka kohë	8,5	9,1
Policia nuk do të ishte shqetësuar / nuk do ishte e interesuar	5,8	5,3
U përpoq ta denonconte por policia nuk ishte e interesuar	3,0	0,8
Nuk e pëlqen / ka frikë nga policia / përvojën e mëparshme e keqe me policinë	1,2	12,7
Tjetër	0,6	6,3
E ka denoncuar ndonjë organ tjetër	0,0	1,8
Probleme me lejen e qëndrimit – andaj s'mund ta denonconte	0,0	0,0
Nuk e ka denoncuar për shkak të vështirësive gjuhësore	0,0	2,4
<i>Gjithsej (e paponderuar n)</i>	<i>53</i>	<i>90</i>

Arsyeja më e shpeshtë që u ofrua nga pak më shumë se një e treta e viktimave të krimeve të urrejtjes për mos denoncimin në polici të krimin më të rëndë që kishin përjetuar ishte pranimi se kjo është thjesht diçka që ndodh. Një në gjashtë viktimat të krimeve të urrejtjes deklaruan se rasti kishte qenë tepër banal dhe nuk ia vlente të denoncohej.

Një e treta e viktimave të krimeve të urrejtjes thanë gjithashtu se nuk ishin të sigurt se policia do të ishte në gjendje të bënte gjë, dhe një numër i vogël - pak më shumë se një në njëzet viktimat të krimeve të urrejtjes - deklaruan se policia nuk do të ishte e shqetësuar apo e interesuar.

Sondazhi i EU-MIDIS II-it doli me gjetje të ngjashme: arsyeja më e shpeshtë që u ofrua nga viktimat e ngacmimeve të motivuara nga urrejtja dhe gjithashtu nga viktimat e dhunës së motivuar nga urrejtja për mos raportimin e incidenteve në polici apo ndonjë autoritet tjetër ishte perceptimi se asgjë nuk do të ndodhte ose nuk do të ndryshonte duke denoncuar incidentin.

TRAJTIMI NGA POLICIA

Të anketuarit të cilët raportuan për krimin më të rëndë që kishin përjetuar në polici u pyetën një sërë pyetjesh se si ata e perceptonin kontaktin dhe trajtimin nga policia (Tabela 3).

Nuk kishte asnjë model të qëndrueshëm të dallimit midis përgjigjeve të viktimave të krimeve të urrejtjes dhe viktimave të krimeve të tjera. Viktimat e krimeve të urrejtjes kishin më pak gjasa të thonë se ata ishin trajtuar në mënyrë të drejtë nga policia dhe se ishin trajtuar me respekt. * Megjithatë, ata kishin më shumë gjasa sesa viktimat e krimeve të tjera për të deklaruar se policia i kishte mbajtur të informuar për përparimin e rastit të tyre dhe të njëjtit shprehën një nivel pak më të lartë të kënaqësisë me policinë krahasuar me viktimat e krimeve të tjera.*

Përqindja e viktimave të krimeve të urrejtjes në këtë hulumtim të krimeve të urrejtjes të cilët ishin të pakënaqur me përgjigjen e policisë pas një denoncimi (45.4%) ishte më i ulët se 63% e viktimave të ngacmimeve të motivuara nga urrejtja në hulumtimin EU-MIDIS II të cilët thanë se ishin të pakënaqur nga mënyra se si policia u morr me këtë çështje³⁰.

TABELA 3: TRAJTIMI I POLICISË

	Krimi i urrejtjes %	Krime të tjera %
SA E LEHTË APO E VËSHTIRË ISHTE QË JU TË KONTAKTONI DIKË NGA POLICIA QË MUND TË MERRET ME KËTË ÇËSHTJE?		
Shumë e lehtë	26,7	29,0
Mjaft e lehtë	26,3	23,5
As e lehtë as e vështirë	46,1	33,8
Mjaft e vështirë	0,9	10,7
Shumë e vështirë	0,0	3,0

³⁰ Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA) (2017) EU-MIDIS II: Second European Union minorities and discrimination survey, Vienna: European Union Agency for Fundamental Rights, faqe 63.

TABELA 3: TRAJTIMI I POLICISË

A MENDONI SE POLICIA JU KA TRAJTUAR NË MËNYRË TË DREJTË?		
Po	40,1	46,5
Jo tërësisht	26,3	15,4
Aspak	21,1	12,6
Nuk jam i/e sigurt	12,4	25,5
A MENDONI SE POLICIA JU KA TRAJTUAR ME RESPEKT?		
Po	49,5	54,4
Jo tërësisht	12,4	20,3
Aspak	22,3	7,3
Nuk jam i/e sigurt	15,9	17,9
SA MIRË JU INFORMOI POLICIA PËR PROGRESIN NË KËTË RAST?		
Shumë mirë	6,5	10,7
Mjaft mirë	30,3	17,5
Jo shumë mirë	30,6	24,7
Aspak mirë	9,9	31,7
Nuk ka nevojë të më informojë	22,7	15,4
NË TËRËSI, A JENI PËRGJITHËSISHT TË KËNAQUR APO TË PAKËNAQUR ME MËNYRËN SE SI POLICIA ËSHTË MARRË ME KËTË ÇËSHTJE?		
I/e kënaqur	10,9	10,9
Mjaft i/e kënaqur	30,3	24,2
Pak i/e kënaqur	12,9	12,6
I/e pakënaqur	32,5	38,6
As i/e kënaqur as i/e pakënaqur	9,6	8,3
Nuk e di	3,8	5,5
<i>Gjithsej (e paponderuar n)</i>	<i>[35]</i>	<i>85</i>

8. NDIKIMI I VIKTIMIZIMIT NGA KRIMI I URREJTJES

Shumë viktima të krimit vuajnë ndonjë efekt pas viktimizimit. Në rastin e krimit të urrejtjes, një trup ndërkombëtar i provave kërkimore tregon se efekti për viktimat e krimeve të urrejtjes mesatarisht mund të jetë më i madh se ndikimi i krimit pa rrethanën rënduese të urrejtjes. Ka dëshmi ndërkombëtare se një kuptim i tillë ka mbështetur politikën qeveritare dhe ka motivuar ndërhyrjen e agjencisë së drejtësisë dhe të drejtësisë penale kundër krimit të urrejtjes³¹.

Rrjedhimisht, në këtë hulumtim të krimeve të urrejtjes viktimat që raportuan krimin më të rëndë që kishin përjetuar në 12 muajt para hulumtimit u pyetën një sërë pyetjesh rreth efekteve të mundshëm pas viktimizimit. Kjo pjesë e raportit paraqet rezultatet që përqendrohen ndaras në llojet e ndryshme të efektit post-viktimizues të identifikuar në literaturën kërkimore deri më sot - ndikimet socio-emocionale, psikologjike, psikosomatike dhe të sjelljes - dhe gjithashtu përqendrohet në lidhjen ndërmjet përvojës së viktimizimit aktual nga krimi dhe ngre çështjen e viktimizimit të mundshëm. Gjithashtu, janë paraqitur rezultatet mbi reagimet post-traumatike të stresit pas viktimizimit nga krimi.

Për secilën nga këto masa të efektit pas viktimizimit, hulumtimi zbuloi se viktimat e krimeve të urrejtjes si grup kishin më shumë gjasa të raportonin nivele më të larta të efektit sesa viktimat e tjera të krimit. Konsistenca e rezultateve dhe korrespondenca e tyre me provat ndërkombëtare janë bindëse.

TË QENIT TË PREKUR NGA VIKTIMIZIMI NGA KRIMI

Të anketuarit u pyetën për krimin më të rëndë që e kanë përjetuar, “Në përgjithësi, sa keni qenë të prekur?”. Veçanërisht, viktimat e krimeve të urrejtjes kishin më shumë tendencë sesa viktimat e krimeve të tjera të deklarojnë se ato ishin “shumë” ose “mjaft” të prekur nga krimi.

TABELA 4: TË QENIT TË PREKUR NGA VIKTIMIZIMI NGA KRIMI

	Krime i urrejtjes %	Krime të tjera %
NË PËRGJITHËSI, SA KENI QENË I/E PREKUR?		
Shumë	27,7	22,1
Mjaft	38,7	30,0
Vetëm pak	33,6	47,9
<i>I pponderuar n</i>	90	207

³¹ Giannasi, P. [2014] 'Academia from a Practitioner's Perspective: A Reflection on the Changes in the Relationship between Academia, Policing and Government in a Hate Crime Context' in Neil Chakraborti and Jon Garland (eds.) Responding to Hate Crime: The Case for Connecting Policy and Research, Bristol: Policy Press. Shih gjithashtu: <https://impact.ref.ac.uk/CaseStudies/CaseStudy.aspx?Id=43547>

EFEKTET SOCIO-EKONOMIKE

Viktimat e krimit të urrejtjes si një grup kishin gjasa dy herë më të mëdha sesa viktimat e krimeve tjera për të raportuar se kishin probleme të mëdha me familjarët ose miqtë si pasojë e përvojës së tyre (Tabela 5).

TABELA 5: PROBLEMET SOCIO-EKONOMIKE PAS VIKTIMIZIMIT NGA KRIMI		
	Krimi i urrejtjes %	Krime të tjera %
TË QENIT VIKTIMË E KËTIJ KRIMI, A KA NDIKUAR QË TË KENI PROBLEME TË MËDHA ME FAMILJARËT OSE ME MIQTË, PËRFSHI EDHE MË SHUMË ZËNKA OSE KONFRONTIME SE MË PARË, DUKE MOS NDIER SE MUND T'U BESONI AQ SHUMË?		
Po	30,6	13,3
Jo	67,7	84,3
Nuk e di	1,7	2,4
TË QENIT VIKTIMË E KËTIJ KRIMI, A KA NDIKUAR QË TË KENI PROBLEME TË MËDHA NË PUNË OSE NË SHKOLLË, OSE PROBLEME ME SHEFIN, KOLEGËT APO MOSHATARËT TUAJ?		
Po	15,5	7,5
Jo	84,5	91,9
Nuk e di	0,0	0,5
<i>l paponderuar n</i>	<i>90</i>	<i>207</i>


Ata gjithashtu kishin tendencë pak më shumë se dy herë më të madhe të raportojnë se kanë pasur probleme të rëndësishme në shkollë ose punë pas përvojës së tyre. * Këto pyetje në lidhje me efektin socio-emocional u nxorën nga Studimi Kombëtar i Viktimizimit të Krimit në SHBA, i cili në mënyrë të ngjashme tregon se viktimat e krimeve të urrejtjes si një grup kanë më shumë gjasa të raportojnë për një efekt të tillë³².

EFEKTE PSIKOLOGJIK

Një sërë pyetjesh që iu parashtruan të anketuarve rreth efekteve të mundshëm psikologjike të viktimizimit të krimit u morën nga Hulumtimi i krimit për Anglinë dhe Uellsin. Jo të gjithë të anketuarit kanë raportuar se përjetojnë secilën nga efektet. Megjithatë, është shumë e dukshme që në secilën prej masave të përdorura viktimat e krimeve të urrejtjes si një grup kanë më shumë gjasa të raportojnë efekte të tilla psikologjike pas viktimizimit sesa viktimat e krimeve të tjera (Figura 12).

³² Shih: Iganski, P. & Lagou, S. (2016) 'The psychological impact of hate crimes on victims: an exploratory analysis of data from the U.S. National Crime Victimization Survey', in Dunbar, E.W. (ed.) The psychology of hate crimes as domestic terrorism, Santa Barbara, CA: Praeger, page 287.

Figura 12: Efekti psikologjik mbi viktimat e krimit të urrejtjes



n: Viktima të krimit të urrejtjes= 90, Viktima të krimeve të tjera = 207

Modeli i dallimit midis viktimave të krimeve të urrejtjes dhe viktimave të krimeve të tjera në lidhje me përgjigjen psikologjike pas viktimizimit është në përputhje me rezultatet e Hulumtimit të krimit për Anglinë dhe Uellsin³³ - deri në atë masë që zemërimi dhe humbja e besimit janë në mesin e efekteve më të shpeshta të raportuar nga viktimat e krimit të urrejtjes³⁴. Modeli i ndryshimit është gjithashtu në përputhje me provat nga Hulumtimi Kombëtar të SHBA-ve për Viktimizimin e Krimit³⁵.

SHQETËSIMI RRETH VIKTIMIZIMIT POTENCIAL NGA KRIMI

Një ekzaminim i lidhjes ndërmjet viktimizimit aktual nga krimi dhe shqetësimit për viktimizimin e mundshëm ndër personal nga krimi gjithashtu tregon një model të qartë të dallimit në mes të anketuarve që ishin viktima të krimit të urrejtjes dhe viktima të krimeve të tjera (Tabela 6).

³³ Shih: Iganski, P. & Lagou, S. (2014) 'The personal injuries of "hate crime"', in Hall, N., Corb, A., Giannasi, P. and Grieve, J. (eds.) The Routledge International Handbook on Hate Crime, London: Routledge, pp. 41-43.

³⁴ Dallimet e vërejtura për zemërimin, goditjen, depresionin, sulmet e ankthit / panikut, fjetja e vështirë, bezdi, të pambrojtura, të dhunuara dhe të pasigurta nuk do të ishin në mënyrë statistikore të rëndësishme nëse të dhënat janë gjeneruar nga një mostër probabiliteti. Megjithatë, qëndrueshmëria e gjetjeve të anketës me provat nga Anketimi i Krimit për Anglinë dhe Uellsin dhe Studimi Kombëtar i Viktimizimit nga Krimi të Shteteve të Bashkuara nënvizon besueshmërinë e tyre dhe tregon se ka të ngjarë që me një madhësi më të madhe të mostrave të gjitha dallimet do të ishin në mënyrë statistikore të rëndësishme.

³⁵ Shih: Iganski, P. & Lagou, S. (2016) 'The psychological impact of hate crimes on victims: an exploratory analysis of data from the U.S. National Crime Victimization Survey', in Dunbar, E.W. (ed.) The psychology of hate crimes as domestic terrorism, Santa Barbara, CA: Praeger, page 288.

**TABELA 6:
SHQETËSIMI RRETH VIKTIMIZIMIT POTENCIAL NGA KRIMI**

	Krime i urrejt jes kolona %	Krime të tjera kolona %
SA SHQETËSOHENI OSE JO SE MUND T'JU SULMOJNË DHE T'JU GRABISIN?		
Shumë i/e shqetësuar	23,1	22,4
Mjaft i/e shqetësuar	59,4	43,5
Jo shumë i/e shqetësuar	15,1	26,5
Aspak i/e shqetësuar	2,3	7,6
SA SHQETËSOHENI OSE JO SE MUND T'JU SULMOJNË FIZIKISHT TË PANJOHUR?		
Shumë i/e shqetësuar	33,7	18,0
Mjaft i/e shqetësuar	47,3	40,3
Jo shumë i/e shqetësuar	17,9	26,1
Aspak i/e shqetësuar	1,1	15,6
SA SHQETËSOHENI OSE JO SE MUND T'JU SULMOJNË FIZIKISHT PËR SHKAK TË ORIGINËS SUAJ ETNIKE, RACORE APO KOMBËTARE APO BESIMIT FETAR?		
Shumë i/e shqetësuar	16,2	14,2
Mjaft i/e shqetësuar	44,8	38,6
Jo shumë i/e shqetësuar	27,5	31,4
Aspak i/e shqetësuar	11,5	15,7
SA SHQETËSOHENI OSE JO SE MUND T'JU NGACMOJNË, TRAZOJNË APO SHQETËSOJNË NË VENDE PUBLIKE OSE NË SHKOLLË OSE NË PUNË, PËR SHKAK TË ORIGINËS SUAJ ETNIKE, RACORE APO KOMBËTARE APO BESIMIT FETAR?		
Shumë i/e shqetësuar	13,4	12,2
Mjaft i/e shqetësuar	46,1	29,2
Jo shumë i/e shqetësuar	26,8	34,8
Aspak i/e shqetësuar	13,7	23,8
SA SHQETËSOHENI OSE JO SE MUND T'JU SULMOJNË SEKSUALISHT?		
Shumë i/e shqetësuar	15,8	10,0
Mjaft i/e shqetësuar	42,3	18,1
Jo shumë i/e shqetësuar	17,4	23,6
Aspak i/e shqetësuar	24,6	48,3

**TABELA 6:
SHQETËSIMI RRETH VIKTIMIZIMIT POTENCIAL NGA KRIMI**

SA SHQETËSOHENI OSE JO SE MUND T'JU OFENDOJNË OSE T'JU KËRCËNOJNË NË MEDIET SOCIALE?		
Shumë i/e shqetësuar	9,1	4,4
Mjaft i/e shqetësuar	38,3	16,1
Jo shumë i/e shqetësuar	20,2	26,9
Aspak i/e shqetësuar	17,9	25,4
Nuk përdor kurrë mediet sociale	14,6	27,3
<i>l paponderuar n</i>	<i>90</i>	<i>207</i>

Kjo shoqatë duket se nuk është hulumtuar në provat ndërkombëtare deri tani lidhur me viktimizimin nga krimi i urrejtjes. Ky hulumtim për krimet e urrejtjes, pra, ofron njohuri unike rreth ndikimit të krimit të urrejtjes.

Duhet vënë në pah se për secilën prej masave të përdorura që kanë të bëjnë me shqetësimin rreth viktimizimit ndër personal të mundshëm nga krimi – shqetësimi nga mundësia e sulmit dhe grabitjes; shqetësimi nga mundësia e sulmit fizik nga të panjohur; shqetësimi nga mundësia e sulmit fizik, ngacimit, trazimit dhe shqetësimi, për shkak të origjinës etnike, racore apo kombëtare apo besimit fetar; shqetësimi nga sulmi seksual dhe shqetësimi nga ofendimi ose kërcënimi në mediet sociale, viktimat e krimeve të urrejtjes në hulumtim kishin më shumë tendencë sesa viktimat e krimeve të tjera për të deklaruar se ata ishin shumë të shqetësuar dhe mjaft të shqetësuar³⁶.

SIMPTOMA PSIKOSOMATIK


Të anketuarit që raportuan se kishin qenë viktimë e krimeve të urrejtjes kishin më shumë tendencë që të raportnin simptoma psikosomatike si dhimbje koke, probleme me fjetje, ndryshime në zakonet e të ngrënit dhe të pirjes, stomak i shqetësuar, lodhje dhe tensioni i muskujve (Figura 13)³⁷. Pyetjet në lidhje me reagimet psikosomatike pas viktimizimit nga krimi u nxorën nga Hulumtimi Kombëtar i Viktimizimit të Krimit në SHBA, i cili në mënyrë të ngjashme tregon se viktimat e krimeve të urrejtjes si grup kanë më shumë gjasa të raportojnë simptoma psikosomatike³⁸.

³⁶ Dallimii vërejtur në shqetësimin për sulm fizik për shkak të prejardhjes etnike, raciale, kombëtare ose fesë nuk do të ishte në mënyrë statistikore e rëndësishme nëse të dhënat janë gjeneruar nga një mostër e probabilitetit.

³⁷ Vetëm dallimet e vërejtura për ndryshimet në zakonet e të ngrënit apo të pijes dhe stomakut të shqetësuar do të ishin statistikisht të rëndësishme nëse të dhënat janë gjeneruar nga një mostër e zgjedhur rastësisht. Megjithatë, përputhshmëria e gjetjeve të hulumtimit me provat e hulumtimit nga Hulumtimi Kombëtar i Viktimizimit nga krimi i Shteteve të Bashkuara nënvizon besueshmërinë e tyre dhe tregon se ka të ngjarë që me një madhësi më të madhe të mostrave, të gjitha ndryshimet e vërejtura do të ishin në mënyrë statistikore të rëndësishme.

³⁸ Shih: Iganski, P. & Lagou, S. (2016) 'The psychological impact of hate crimes on victims: an exploratory analysis of data from the U.S. National Crime Victimization Survey', in Dunbar, E.W. (ed.) The psychology of hate crimes as domestic terrorism, Santa Barbara, CA: Praeger, page 289.

Figura 13 : Reaksion psikosomatik pas viktimizimit nga krimi



n: Viktima të krimit të urrejtjes = 90, Viktima të krimeve të tjera 207

SJELLJA E SHMANGIES SË KRIMIT

Mbase e kuptueshme, duke pasur parasysh nivelin më të madh të shqetësimit për viktimizimin e mundshëm ndër personal nga krimi i raportuar nga viktimat e krimit në hulumtim, ata gjithashtu kishin më shumë gjasa të deklarorin se i shmangnin vendet e caktuara - siç janë dyqanet, kafenetë, transportin publik, objekte të sportit apo objektet kulturore dhe vende të tjera publike - nga frika se do të trajtohen keq për shkak të origjinës së tyre etnike, racore apo kombëtare, të religjionit të tyre ose të bindjeve të tyre politike (Tabela 7)³⁹.

TABELA 7: SJELLJA E SHMANGIES SË KRIMIT

	Krime i urrejtjes %	Krime të tjera %
A KENI SHMANGUR VENDE TË CAKTUARA, SIÇ JANË DYQANET, KAFENETË, TRANSPORTIN PUBLIK, OBJEKTE TË SPORTIT APO OBJEKTET KULTURORE APO NDONJË VEND TJETËR PUBLIK, NGA FRIKA SE DO TË KEQTRAJTOHENI PËR SHKAK TË ORIGJINËS TUAJ ETNIKE, RACORE APO KOMBËTARE APO TË FESË?		
Po	58,2	34,7
Jo	41,8	65,3
A KENI SHMANGUR VENDE TË CAKTUARA, SIÇ JANË DYQANET, KAFENETË, TRANSPORTIN PUBLIK, OBJEKTE TË SPORTIT APO OBJEKTET KULTURORE APO NDONJË VEND TJETËR PUBLIK, NGA FRIKA SE DO TË KEQTRAJTOHENI PËR SHKAK TË BINDJEVE POLITIKE?		
Po	44,2	32,3
Jo	55,8	67,7
<i>I paponderuar n</i>	<i>90</i>	<i>207</i>

³⁹ Dallimi i vërejtur në lidhje me sjelljen e shmangies për shkak të bindjeve politike do të ishte thjesht nën rëndësinë statistikore nëse të dhënat janë gjeneruar nga një mostër e zgjedhur në mënyrë të rastësishme.

Modeli i dallimit midis viktimave të krimeve të urrejtjes dhe viktimave të krimeve të tjera në lidhje me sjelljen e shmangies së krimit me prova nga Hulumtimi i krimit për Anglinë dhe Uellsin.⁴⁰

REAKSIONE POST-TRAUMATIKE TË STRESIT

Së fundi, për krimet më të rënda, të anketuarve iu ofruan shtatëmbëdhjetë reaksione post-traumatike të stresit⁴¹ (Tabela 8) dhe u kërkua të tregonin nëse gjatë muajit të kaluar kishin pasur ndonjë nga këto shqetësime për shkak të krimit që kishin përjetuar. Përgjigjet çdo reagim shtriheshin në një shkallë nga „Jo aspak” deri te „Pesë ose më shumë herë në javë / pothuajse gjithmonë”. Kur krahasohet rezultati mesatar (duke përdorur një shkallë prej 0 deri në 4) për secilën reagim për viktimat e krimeve të urrejtjes me viktimat e krimeve të tjera, është e dukshme që për çdo reagim urrejtja e viktimave të krimit si grup ka shënuar më shumë se viktimat e krimeve të tjera si grup – rezultoi se viktimat e krimeve të urrejtjes kishin më shumë gjasa të raportonin se kishin pasur shqetësim në muajin e kaluar. Nëse llogaritet një mesatare e përgjithshme e të gjitha pikëve mesatare atëherë është gjithashtu e dukshme që rezultati i përgjithshëm i viktimave të krimeve të urrejtjes ($\bar{x} = 0.718$) ishte më i madh se mesatarja e përgjithshme për viktimat e krimeve të tjera ($\bar{x} = 0.506$).

Viktimat e krimit të urrejtjes kishin më shumë gjasa sesa viktimat e krimeve të tjera për të deklaruar se krimi më i rëndë që kishin përjetuar kishte ndodhur brenda katër muajve përpara sondazhit. Sidoqoftë, edhe kur kontrolloheshin për këtë duke shqyrtuar reagimet post-traumatike të raportuara për ata të anketuar që kishin përjetuar krimin më të rëndë në katër muajt para hulumtimit, viktimat e krimit të urrejtjes si grup shënuan më shumë në një rezultat mesatar në krahasim me viktimat e krimeve të tjera (viktimat të krimeve të urrejtjes $x = 0.987$; viktimat të tjera të krimit $x = 0.588$)

TABELA 8: REAKSIONE POST-TRAUMATIKE TË STRESIT		
	Krime i urrejtjes \bar{x}	Krime të tjera \bar{x}
Mendime ose imazhe tronditëse rreth ngjarjes traumatike që ju vinin në kokë kur nuk i dëshironit	1,1319	0,7282
Jeni ndjerë emocionalisht i/e shqetësuar kur keni kujtuar ngjarjet traumatike	0,9778	0,8633
Keni qenë tepër vigjilent	0,9101	0,5080
Ndjenjë nervozizëm ose shpërthime të zemërimit	0,8938	0,7023
Jeni me nerva ose trembeni lehtë;	0,8904	0,5282
Përpiqeni mos të mendoni, të flisni, ose të keni ndjenja rreth ngjarjes traumatike	0,7880	0,6375
Ndjeheni i/e distancuar ose i prerë nga njerëzit rreth jush	0,7041	0,3609
Ndjeheni emocionalisht i/e mpirë	0,6601	0,2943
Përjetoni sërish ngjarjen traumatike, duke vepruar ose duke u ndjerë sikur po ndodhte sërish	0,6379	0,5421

⁴⁰ Iganski & Lagou (2014) Op. cit. pp.43-44.

⁴¹ I përshtatur nga: Foa, E., Cashman, L., Jaycox, L., & Perry, K. (1997) 'The validation of a self-report measure of PTSD: The Posttraumatic Diagnostic Scale', Psychological Assessment, 9, 445-451.

TABELA 8: REAKSIONE POST-TRAUMATIKE TË STRESIT		
Keni ndjerë reaksion fizik kur keni kujtuar ngjarjet traumatike	0,6312	0,5866
Keni pasur shumë më pak interes ose keni marrë pjesë shumë më rrallë në aktivitete të rëndësishme	0,6292	0,3583
Përpiqeni të shmangni aktivitetet, njerëzit ose vendet që ju kujtojnë ngjarjen traumatike	0,6234	0,5752
Keni ëndrra të këqija apo ankthe rreth ngjarjes traumatike	0,5780	0,5125
Keni vështirësi për t'u përqendruar	0,5685	0,2961
Vështirë ju zë gjumi dhe nuk arrini të rri në fjetur	0,5663	0,3496
Ndjeni sikur planet ose shpresat e ardhshme nuk do të realizohen	0,5211	0,3160
Nuk jeni në gjendje të kujtoni një pjesë të rëndësishme të ngjarjes traumatike	0,4940	0,4466
<i>I përpunuar n</i>	<i>90</i>	<i>207</i>

9. KONKLUZIONE

Rezultatet e hulumtimit të paraqitura në këtë raport ofrojnë një pasqyrë më të plotë të viktimizimit nga krimi i urrejtjes dhe efektet e tij që janë në dispozicion deri më sot nga numri i vogël i krimeve të urrejtjes të paraqitura më parë nga të dhënat administrative dhe të dhënat e OJQ-ve në Maqedoninë e Veriut.

Nga një mostër prej 1510 të anketuar dhe duke përdorur një numërim konservator dhe të besueshëm për viktimizimin nga krimi, hulumtimi gjeti 165 të anketuar që kishin qenë viktimat të krimit të urrejtjes në 12 muajt para hulumtimit. Ky numër është i rëndësishëm kur merret parasysh se 165 personat që kanë përjetuar krime të urrejtjes ishin pjesë e vetëm një pjese të vogël të popullsisë Maqedonisë së Veriut që u përzgjedhën për hulumtim. Ky zbulim sugjeron që shtrirja aktuale e krimit të urrejtjes në vend ka gjasa të jetë e konsiderueshme. Disa viktimat përjetojnë më shumë se një krim në një periudhë të caktuar kohore. Midis tyre, viktimat e krimit të urrejtjes në hulumtim, kishin përjetuar 222 krime të urrejtjes. Ndërsa kjo shifër bazohet në një mostër të të anketuarve, nuk është një vlerësim. Ai përfaqëson përvojën aktuale të personave që morën pjesë në studim dhe numri i krimeve të urrejtjes tejkalon numrin e të dhënave administrative dhe të të dhënave të OJQ-ve për Maqedoninë e Veriut.

Hulumtimi gjithashtu ofroi një pasqyrë mbi raportimin e paplotë të krimit dhe krimit të urrejtjes. Gjashtë nga dhjetë krimet e urrejtjes nuk janë denoncuar në polici, dhe gjysma e krimeve të tjera të përfshira nga hulumtimi gjithashtu nuk janë denoncuar. Arsyet që viktimat i dhanë për mos-denoncimin e krimeve që ata përjetuan ishin arsyet e zakonshme të dhëna në hulumtimet mbi viktimizimin nga krimi në nivel ndërkombëtar. Për ato viktimat që i raportojnë krimet policisë, viktimat e krimeve të urrejtjes kishin më pak gjasa të thonë se ata ishin trajtuar në mënyrë të drejtë nga policia dhe se ishin trajtuar me respekt. Megjithatë, ata shprehën një nivel pak më të lartë të kënaqësisë me policinë krahasuar me viktimat e krimeve të tjera.

Rezultatet mbi ndikimin e viktimizimit nga krimi i urrejtjes ofron një kuptim më të madh dhe inovacione të mëtejshme. Për besueshmërinë e matjes dhe gjithashtu për qëllime krahasuese ky studim i krimeve të urrejtjes aplikoi matjet e ndikimit të viktimizimit nga krimi të përdorura në një sërë hulumtimesh ndërkombëtare. Në kombinim, masat përbënin ekzaminimin më të gjerë deri më sot për ndikimin e krimit të urrejtjes. Rezultatet konfirmojnë një model që tashmë ishte në provë nga hulumtimet në nivel ndërkombëtar: viktimat e krimeve të urrejtjes kanë më shumë gjasa që të raportojnë pas-viktimizimin e efekteve socio-emocionale, psikologjike, psikosomatike dhe të sjelljes krahasuar me viktimat e tjera të krimit si një grup. Këto modele të dukshme në rezultatet e këtij hulumtimi të krimit të urrejtjes gjithashtu konfirmojnë qëndrueshmërinë e hulumtimit. Duke shkuar përtej provave ndërkombëtare deri tani, ky hulumtim mbi krimet e urrejtjes gjithashtu tregon se viktimat e krimeve të urrejtjes kanë më shumë gjasa sesa viktimat e krimeve të tjera për të shprehur shqetësimin rreth viktimizimit të mundshëm nga krimi. Ata gjithashtu kanë më shumë gjasa të raportojnë simptomat e stresit post-traumatik. Të gjitha këto gjetje në lidhje me ndikimin e viktimizimit nga krimi i urrejtjes kanë implikime të rëndësishme për nevojën e zhvillimit të masave efektive që përgjigjen dhe luftojnë krimin e urrejtjes, si dhe nevojën për politikë dhe strategji të synuar nga autoritetet kombëtare dhe lokale dhe organizatat e shoqërisë civile.

SHTOJCA 1

Komunat e përfshira në hulumtim sipas përbërjes së grupeve etnike sipas regjistrimit të vitit 2002

	<i>Gjithsej (N)</i>	<i>Shqiptarë</i>	<i>Boshnjak</i>	<i>Maqedonas</i>	<i>Romë</i>	<i>Serbë</i>	<i>Turq</i>	<i>Vlleh</i>	<i>Të tjerë</i>
Bërvenicë	15.855	61,6	0,0	37,5	0,0	0,5	0,0	0,0	0,3
Butel	36.154	25,2	2,7	62,3	1,6	2,9	3,6	0,3	1,5
Çair	64.773	57,0	4,6	24,1	4,8	1,0	6,9	0,1	1,5
Çashkë	7.673	35,2	0,9	57,3	0,0	0,7	5,1	0,0	0,8
Çuçer-Sandevë	8.493	22,9	0,0	47,3	0,3	28,6	0,0	0,2	0,8
Dollnen	13.568	26,7	17,5	35,9	0,1	0,1	19,1	0,0	0,6
Gazi Babë	72.617	17,2	1,0	73,7	2,9	2,9	0,8	0,3	1,2
Jegunoc	10.790	43,0	0,0	55,3	0,4	1,0	0,0	0,0	0,3
Kërçovë	30.138	30,5	0,0	53,6	5,4	0,3	8,1	0,3	1,9
Krushevë	9.684	21,3	1,4	62,8	0,0	0,4	3,3	10,5	0,3
Kumanovë	105.484	25,9	0,0	60,4	4,0	8,6	0,3	0,1	0,6
Mavrovë dhe Rostushë	8.618	17,2	0,4	50,5	0,1	0,1	31,1	0,0	0,7
Petrovec	8.255	22,9	17,5	51,4	1,6	5,0	0,9	0,0	0,7
Resnjë	16.825	9,1	0,0	76,1	1,1	0,4	10,7	0,2	2,4
Sopishte	5.656	34,3	0,0	60,2	0,0	0,6	4,3	0,1	0,5
Strugë	63.376	56,8	0,2	32,1	0,2	0,2	5,7	1,0	3,8
Tetovë	86.580	70,3	0,2	23,2	2,7	0,7	2,2	0,0	0,7
Zelenikovë	4.077	29,6	4,7	61,9	2,3	1,1	0,0	0,0	0,5

SHTOJCA 2

Madhësia e mostrës për secilën komunë të përzgjedhur sipas përbërjes etnike

	Shqiptarë	Boshnjak	Maqedonas	Myslimanë	Romë	Serbë	Turq	Vlleh	Maqedonas myslimanë	Të tjerë	Preferoj mos t a them	Gjithsej
Butel	23	4	56	1	2	4	2	2	1	0	0	95
Bërvenicë	26	0	16	0	0	0	0	0	0	0	0	42
Çair	96	8	42	0	7	2	12	2	0	2	0	171
Çashkë	7	0	12	0	0	0	1	0	0	0	0	20
Çuçer-Sandevë	5	1	9	0	1	6	0	0	0	0	0	22
Dollnen	9	7	12	1	0	0	6	0	1	0	0	36
Gazi Babë	35	2	140	0	6	6	1	2	0	1	1	194
Jegunoc	12	0	16	0	0	0	0	0	0	0	0	28
Kërçovë	25	0	45	3	4	0	6	0	0	0	0	83
Krushevë	2	0	9	0	0	0	0	15	0	0	0	26
Kumanovë	71	0	169	0	11	24	1	1	0	1	0	278
Mavrovë dhe Rostushë	4	0	5	2	0	0	8	0	4	0	0	23
Petrovec	6	6	9	0	0	0	0	0	0	0	1	22
Resnjë	4	0	31	0	0	0	7	1	0	0	1	44
Sopishte	5	0	10	0	0	0	0	0	0	0	0	15
Strugë	93	0	51	2	0	1	9	8	2	0	1	167
Tetovë	167	1	52	0	6	1	5	0	0	0	1	233
Zelenikovë	2	0	9	0	0	0	0	0	0	0	0	11
Вкупно	592	29	693	9	37	44	58	31	8	4	5	1510

